



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe për çështje lidhur me të

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit kujdestar për Jakup Krasniqin
Hans Van de Val

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 20 dhe 39(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 8(3)(a), 87(6), 92(1) dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZSP”) dorëzoi një aktakuzë konfidenciale dhe *ex parte* për konfirmim së bashku me material provues në mbështetje të fakteve dhe një përmbledhje të detajuar që demonstroi lidhjen e çdo prove me secilën akuzë.²
2. Më 24 korrik 2020, ZSP-ja paraqiti, pas urdhrit,³ një aktakuzë të rishikuar për konfirmim (“Aktakuza e Rishikuar”).⁴
3. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e rishikuar (“Vendimi i konfirmimit”),⁵ lëshoi fletarrestimin për Jakup Krasniqin (“z. Krasniqi” ose “i akuzuari”)⁶ dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin a paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”).⁷

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i aktakuzës për konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores*, 2 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim*, 24 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* (“Vendimi i konfirmimit”), 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00027/A07/COR, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i korrigjuar i fletarrestimit për Jakup Krasniqin*, 28 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00028/A08/COR, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i korrigjuar i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 28 tetor, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

4. Më 30 tetor 2020, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzën e konfirmuar⁸, me redaktime të autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁹
5. Më 4 nëntor 2020, z. Krasniqi u arrestua¹⁰ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së, në Hagë, Holandë.¹¹
6. Më 4 nëntor 2020, Administratorja caktoi z. Hans Van de Val si mbrojtës kujdestar për z. Krasniqi.¹²

II. DISPIOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARAQITJA E PARË

7. Sipas nenit 39(4) të Ligjit, një person kundër të cilit është konfirmuar një aktakuzë, merret në ndalim në pajtim me një urdhër ose një fletarrestim të lëshuar nga Dhomat e Specializuara, informohet menjëherë për akuzat kundër tij ose saj dhe transferohet në Dhomat e Specializuara.
8. Sipas rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake për paraqitjen e tij ose të saj të parë pa vonesë të papërligjur.
9. Sipas neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat, përfshirë seancat e paraqitjes së parë të të akuzuarit, janë publike, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ndryshe në pajtim me Rregulloren.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00034/A03, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar dhe kërkesave në lidhje me të*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar që korrigjoi disa gabime shtypi u dorëzua më 4 nëntor 2020, F00045/A01, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

⁹ Vendimi i konfirmimit, para. 521(c) dhe (d); KSC-BC-2020-06, F00035, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për autorizim të redaktimeve të përkohshme*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 35.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftim për arrestimin e Jakup Krasniqit në pajtim me rregullën 55(4)*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftim për pranimin e Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("Njoftimi i transferimit")*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcë, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹² Njoftim për transferim, para. 3.

B. GJUHËT E PUNËS

10. Sipas nenit 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të DHS-së dhe ZSP-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja dhe në cilindo proces gjyqësor, një panel mund të vendosë në lidhje me gjuhën e punës në atë proces, siç është e përshtatshme dhe duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarit, siç parashihen në bazë të nenit 21 të këtij Ligji.

11. Sipas rregullës 8(3)(a) të Rregullores, në varësi të nenit 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët, dhe kur është e përshtatshme mbrojtësin e viktimave, paneli vendos se cila gjuhë ose gjuhët e punës do të përdoren gjatë procesit.

C. KONFERENCA PËR ECURINË E ÇËSHTJES

12. Sipas rregullës 96(1) të Rregullores Gjykatësi i Procedurës Paraprake thërret konferencën mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejtë që është e mundur pas paraqitjes së parë të akuzuarit për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve, dhe kur është e zbatueshme, mbrojtësit e viktimave, për të shpejtuar përgatitjet për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave që garantojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe me kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes dhe që palëve, dhe kur është e zbatueshme, mbrojtësve të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen.

13. Sipas rregullës 96(2) të Rregullores, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen mbrojtësit të tij ose të saj nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesën e të akuzuarit dhe në praninë ose me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës.

III. DISKUTIM

A. PARAQITJA E PARË

14. Duke marrë parasysh arrestimin e z. Krasniqi dhe transferimin e tij në objektin e paraburgimit të DHS-së më 4 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron të përshtatshëm caktimin e seancës për paraqitjen e parë të akuzuarit sa më parë që të jetë e realizueshme, duke mbajtur parasysh kufizimet për shkak COVID-19 dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të tij sipas Ligjit.

15. Gjithashtu, duke theksuar se seanca mund të bëhet publike edhe jashtë sallës së gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon bërjen e fotografive në fillim të seancës së paraqitjes së parë.

B. GJUHËT E PUNËS

16. Duke pasur parasysh arrestimin dhe transferimin e z. Krasniqi dhe në pajtim me të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21 të Ligjit, është e nevojshme të caktohet gjuha e punës në procesin aktual me qëllim që të mundësohet zhvillimi i drejtë, efikas dhe i shpejtë i tij. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjatë paraqitjes së parë urdhëron palët të paraqesin mendimet e tyre me gojë në lidhje me gjuhën e punës gjatë procesit.

17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, deri më sot, anglishtja ka qenë gjuha e punës gjatë procesit, si dhe të gjitha parashtrimet nga ZSP-ja dhe Administratorja, dhe të gjitha vendimet dhe urdhrat nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake janë lëshuar në anglishte. Rrjedhimisht, pasi t'i ketë marrë mendimet nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vendosë se a ekzistojnë arsye bindëse për t'u larguar nga përdorimi i anglishtes si gjuhë pune.

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se caktimi i gjuhës së punës gjatë procesit nuk ndikon në gjuhë dhe/ose përkthimin e provave dhe dokumenteve tjera të nevojshme për përdorim nga i akuzuari.¹³

C. DATA E PARAQITJES SË PARË

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton palët që në paraqitjen e parë të bëjnë me dije në lidhje me disponueshmërinë e tyre për një konferencë mbi ecurinë e çështjes më 18 nëntor 2020, apo pas kësaj date. Mbrojtja ftohet të bëjë me dije në parashtrimin e vet se a do të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes, nëpërmjet pranisë fizike, apo nëpërmjet videokonferencës, siç parashikohet sipas rregullës 96(2) të Rregullores.

D. VERSIONET E REDAKTUARA TË VENDIMIT TË KONFIRMIMIT

20. Që vendimi i konfirmimit të vihet në dispozicion të të akuzuarit dhe publikut , Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZSP-në që të dorëzojë parashtrime me shkrim nëse ka, deri më 16 nëntor, në lidhje me redaktimet e propozuara që duhet të zbatohen në atë vendim.

IV. VENDIM

21. Për arsytet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të thërrasë seancën e paraqitjes së parë të z. Krasniqi të **hënën, 9 nëntor 2020, në orën 11:00;**
- b) **AUTORIZON** Administratoren të organizojë, në fillim të seancës së paraqitjes së parë, bërjen e fotografive për një minutë e gjysmë;

¹³ Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores.

- c) **URDHËRON** palët të paraqesin, në paraqitjen e parë, parashtrimet tyre me gojë në lidhje me miratimin e gjuhës së punës për procesin aktual;
- d) **FTON** palët të paraqesin, gjatë paraqitjes së parë, parashtrimet e tyre me gojë, siç është cekur në paragrafin 19 më lart, në lidhje me disponueshmërinë e tyre për një konferencë mbi ecurinë e çështjes të mërkurën më 18 nëntor 2020, ose pas kësaj date ; dhe
- e) **URDHËRON** ZSP-në të dorëzojë deri të hënën, 16 nëntor 2020, ndaras parashtrime me shkrim rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, nëse ka, në lidhje me redaktimet e propozuara që duhet t'i bëhen vendimit të konfirmimit, me qëllim që ai t'u vihet në dispozicion Mbrojtjes dhe publikut.

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 5 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.